

Vendim nr. 8 datë 20.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Sonila Bejtja,	Anëtare
Gent Ibrahim, i,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 20.01.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (S) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SOKOL KOLA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 266, datë 30.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor dhe përsheptimi i procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjykata Administrative e Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sokol Kola i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të VKM-së nr. 509, datë 06.07.2011 për numrin rendor 275-283, pavlefshmërisë absolute të pjesshme për regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK 1453, terren sportiv, të regjistruar sipas VKM-së nr. 509 në emër të Komunës Qendër Fier, detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të fshijë pjesërisht nga regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme subjektin Komuna Qendër Fier për pasurinë nr. 128/1, ZK 1453, vol.3, faqe 203, në pjesën që krijon mbivendosje me pronën e kërkuesit, etj.

2. Me vendimin nr. 4949 (80-2016-4982), datë 25.10.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *“Të shpallë moskompetencën tokësore dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.”*

3. Me vendimin nr. 2035, datë 07.12.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, duke vlerësuar se provat e paraqitura nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, ka vendosur: *“Kthimin e kërkesëpadisë së bashku me aktet. Kundër vendimit të mësipërm lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë...”*. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke kërkuar *shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.4949 (80-2016-4982), datë 25.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr.2035, datë 07.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Shfuqizimi pjesërisht i VKM-së nr.509, datë 06.07.2011 që krijon mbivendosje me vendimin nr.132, datë 14.02.1996 të KKKP-së Fier. Detyrimi i ZVRPP-së Fier që të regjistrojë pronarët sipas vendimit nr.132, datë 14.02.1996 të KKKP-së Fier. Shfuqizimi i aktit administrativ të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr.128/1, ZK 1453, vol.3, faqe 203 në emër të subjektit Komuna Fier për pjesën që krijon mbivendosje me pronën sipas vendimit nr.132, datë 14.02.1996 të KKKP-së Fier. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 101, datë 05.05.2017 të Kolegjit të Gjykatës, është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se kërkuesi nuk ka shterur mjetet për mbrojtjen juridiksionale dhe nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykatat për pretendimet e ngritura prej tij.*

5. Me vendimin nr. 1782 (86-2019-2052), datë 11.06.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2035, datë 07.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me të njëjtin trup

gjykues. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs Avokatura e Shtetit në Gjykatën e Lartë dhe çështja është regjistruar për gjykim me nr. 31003-02127-00-2019, datë 30.10.2019, por nuk rezulton që të jetë shqyrtuar ende.

6. Me kërkesën e datës 25.11.2019, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, si dhe shpërblimin e dëmit. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 6, datë 21.01.2021, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur të shpallë moskompetencën funksionale për shqyrtimin e saj dhe dërgimin e akteve për kompetencë gjykimi në Gjykatën e Lartë.

7. Me vendimin nr. 5/28, datë 17.01.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 6, datë 21.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me të njëjtin trup gjykues.

8. Me vendimin nr. 266, datë 30.06.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e gjykimit, si të pabazuar në ligj.

9. Me kërkesën e datës 24.10.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 266, datë 30.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

II

Pretendimet e kërkuessit

10. **Kërkuesi Sokol Kola** ka pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi edhe pse kërkesa për konstatimin e pavlefshmërisë së VKM-së nr. 509/2011 është dorëzuar në datën 20.10.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka refuzuar gjykimin e çështjes edhe pse ka një vendim të formës së prerë. Duke iu referuar neneve 399 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Civile (KPC), kërkesa për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave duhet të shqyrtohen brenda 45 ditëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në këtë këndvështrim, duke iu kthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit në datën 25.11.2019 me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, si dhe shpërblimin e dëmit, duke qenë se gjykimi i çështjes së themelit, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, nuk kishte filluar ende në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Me vendimin nr. 6, datë 21.01.2021, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur *“të shpallë moskompetencën funksionale për shqyrtimin e kërkesës së tij dhe dërgimin e akteve për kompetencë gjykimi në Gjykatën e Lartë, pasi referuar shkresës nr. 49 prot., datë 24.02.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të paraqitur si provë nga vetë kërkuuesi, dosja gjyqësore ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë, fakt ky i konfirmuar edhe nga shkresa me nr. 2188/2 prot., datë 13.01.2021 e Gjykatës së Lartë administruar së bashku me aktet e dosjes gjyqësore që i përkasin vendimit nr. 2035, datë 07.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 10/2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vlerëson se nuk është në kompetencën e saj gjykimi i kësaj kërkesë dhe për rrjedhojë aktet duhet të dërgohen për kompetencë gjykimi pranë Gjykatës së Lartë.”.*

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 5/28, datë 17.01.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 6, datë 21.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me të njëjtin trup gjykues, duke vlerësuar se *“vendimi nr. 6, datë 21.01.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit. Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në*

interpretimin literal të dispozitës së mësipërme, ka vlerësuar se në kushtet kur për çështjen është ushtruar rekurs dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë, atëherë kompetencën për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, e ka Gjykata e Lartë, pavarësisht faktit se kërkuesi ka pretenduar tejzgjatjen e procedurave dhe qëndrim abuziv të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, (...) për rrjedhojë gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës, në mbështetje të nenit 399/6 të KPC-së është Gjykata Administrative e Apelit.”.

15. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin 266, datë 30.06.2022, objekt i kërkesës në shqyrtim, ka rrëzuar kërkesën e kërkuetit si të pabazuar, duke arsyetuar: *“Dosja gjyqësore ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë, fakt ky i konfirmuar edhe nga shkresa me nr. 2188/2 prot., datë 13.01.2021 dhe nga këqyrja e faqes zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë, regjistruar me datë 30.02.2019, çështje e cila ende nuk është gjykuar. Në këto kushte, kur dosja fizikisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe është në pritje për t’u gjykuar, për shkak të kësaj shtate procedurale Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është në pamundësi totale objektive për të vijuar gjykimin e çështjes, arsye për të cilën kërkesa për shkelje afti të arsyeshëm të gjyimit gjendet e pabazuar në ligj.”.* Kjo gjykatë e ka gjetur të pabazuar kërkesën edhe sipas nenit 399 të KPC-së, pasi *“ky kërkim nuk mund të ngrihet në këtë fazë të procesit pranë kësaj gjykate, pasi neni 399/6, paragrafi 2 dhe 3, parashikon se kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes për përshpejtimin e procedurës, subjekti kërkuet mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit. Kërkesëpadi për shpërblimin e dëmit i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja.”.*

16. Në thelb, kërkesa për përshpejtimin e procedurave është mjet juridik në dispozicion të individit për të garantuar të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e gjyimit brenda një afati të arsyeshëm. Në këto lloj rastesh Gjykata nuk vihet në lëvizje thjesht dhe vetëm për të kontrolluar efektivitetin e mjetit juridik që individ ka në dispozicion për të parandaluar ose riparuar shkeljen e së drejtës kushtetuese, por për të kontrolluar nëse individit i është shkelur ose jo vetë e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Thënë ndryshe, Gjykata, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e gjyimit të themelit që zhvillohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërsa vendimet gjyqësore që shqyrtojnë kërkesat për përshpejtimin e procedurave janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese dhe nuk mund të qëndrojnë në mënyrë autonome nga pretendimi kryesor (shih vendimin nr. 56 datë 20.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve).

17. Kolegji vëren se, pavarësisht se objekt i ankimit kushtetues është kundërshtimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, pretendimin për cenimin e së drejtës kushtetuese për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, kërkuesi e ka lidhur me procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe atë të apelit, ndërkohë që çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë mbi bazë të rekursit të bërë nga Avokatura e Shtetit, siç provohet edhe nga aktet bashkëlidhur dosjes. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e tij, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e sistemit të zakonshëm.

18. Po ashtu, Kolegji vëren se kërkuetit iu kërkuar të saktësonte interesin kushtetues ose të ligjshëm, i cili qëndronte në themel të procesit gjyqësor që pretendonte se po zhvillohej përtej afatit të arsyeshëm në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por ai edhe në aktin “Plotësim të metash” nuk ka sjellë asnjë argument në këtë drejtim përveç disa dokumentave shtesë në lidhje me cilësimin e tij si trashëgimtar ligjor i shtetasit LL.K., i cili është njohur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Fier bashkëpronar i truallit i cili është objekt gjykimi. Pra, ai nuk ka saktësuar interesin e tij, si dhe nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga aktet e kundërshtuara në Gjykatën Kushtetuese, për rrjedhojë, nuk legjitimohet *ratione personae* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

19. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.